



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KESHILLI BASHKIAK DIBER**

VENDIMI 118 Date 15.09.2020

“Për një shtesë në Vendimin Nr.125 datë 20.12.2019 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2020”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, pika dh, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.125, datë 20.12.2019 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe Njësive Administrative për vitin 2020. Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” Ligjin Nr. 57/2020 “Për Pyjet” “. Ligjin nr. 69/2012, datë 21. 06. 2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018, Udhëzimit nr 38, datë 06.10.2015 “ Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionit publik të sistemit arsimor parauniversitar” Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij, datë 15.09.2020 me 20 vota pro 0 vota kundër.

VENDOSI :

1. Një shtesë në vendimin Nr.125 datë 20.12.2019 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2020”
2. Shtimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Dibër me 15 pozicione në strukturën e Sektorit të Pyjeve, Veterinarisë dhe Arsimin Parashkollor.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

KRYETAR KËSHILLI



Adresa: Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi, Albania, Nr.tel 003552182166